

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2024



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



**PROGRAMI I PUNËS
SË BANKËS POPULLORE
TË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË SË VERIUT
PËR VITIN 2024**

Shkup, nëntor 2023

Përmbajtja	
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	1
AKTIVITETET PROGRAMORE.....	1
Qëllimi strategjik 1 - Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare	1
Qëllimi strategjik 2 – Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar	2
Qëllimi strategjik 3 – Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve pagesore të sigurta, inovative dhe efikase	3
Qëllimi strategjik 4 – Përmirësimi i politikës investuese dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave devizore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit.....	4
Qëllimi strategjik 5- Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore .	4
Qëllimi strategjik 6- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies	5
Qëllimi strategjik 7- Edukimi financiar dhe përfshirja	6
Qëllimi strategjik 8- Rritja e vetëdijës për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër.....	7
Qëllimi strategjik 9- Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore.....	8
Kapaciteti institucional 1- Integritetiti dhe besimi në njësinë monetare kombëtare	9
Kapaciteti institucional 2- Burimet njerëzore	10
Kapaciteti institucional 3- Sistemi informativ	10
Kapaciteti institucional 4- Të dhëna statistikore	11
Kapaciteti Institucional 5 – Veprimtaria hulumtuese	11
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE	12
Shtojca 1	13
Shtojca 2.....	19
Shtojca 3.....	21
Shtojca 4.....	22

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesat e përdorura në Programin e Punës kanë këtë kuptim:

BPRMV	Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
PS	Plani strategjik
KG	Kabineti i Guvernatorit
ZKM	Zyra e Këshilltarëve të Menaxhimit
ZSP	Zyra për Strategji dhe Preventivë
DAB	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
DFM	Drejtoria e Stabilitetit Financiar dhe Politikës Makroprudenciale
DRrZB	Drejtoria e Rregullativave Bankare dhe Zgjidhjes së Bankave
DMJL	Drejtoria e Mbikëqyrjes nga Jashtë dhe Licencimit
DTM	Drejtoria e Mbikëqyrjes në Terren
DMKEF	Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Edukimin Financiar
ZMI	Zyra e Mbikëqyrjes së Sistemeve Informative
DPMH	Drejtoria e Politikës Monetare dhe Hulumtimit
DS	Drejtoria e Statistikave
DTF	Drejtoria e Operacioneve në Tregjet Financiare
DSP	Drejtoria e Sistemeve të Pagesave
DFKK	Drejtoria e Financave, Kontabilitetit dhe Kontrollit
DOTh	Drejtoria e Operacioneve të Thesarit
DTI	Drejtoria e Teknologjisë Informatike
DIT	Drejtoria e Infrastrukturës të TI-së
DAP	Drejtoria e Aplikacioneve
NjMS	Njësia e mbikëqyrjes dhe sigurisë të TI-së
DBNj	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
DPJ	Drejtoria e Punës Juridike
DPP	Drejtoria e Prokurimit Publik
DMTS	Drejtoria e Mirëmbajtjes Teknike dhe Sigurisë
BA	Biblioteka dhe Arkivi
GP	Grupa Punuese
NjO	Njësia/Njësitë Organizative
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
BE	Bashkimi Europian
BQE	Banka Qendrore Europiane
BERZh	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
MAKPAM	Modeli për analizën e politikave në Maqedoni
PBB	Prodhimi i brendshëm bruto
IPA	Instrumenti për ndihmë para anëtarësimit
EShS	Enti Shtetëror i Statistikës
ISIDORA	Sistemi i integruar i raportimit nga Banka Popullore, bankat, kursimoret, për qëllime statistikore dhe mbikëqyrëse
SIK	Sistemi i integruar i kontabilitetit
TI	Teknologjia e Informacionit
SOC	Qendra e operacioneve të sigurisë të TI-së
MIP	Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare

LP/FT	Larja e parave/ Financimi i terrorizmit
MIPS	Sistemi Ndërbankar i Pagesave të Maqedonisë
CRIS	Regjistri i kredive (angl. Credit Registry Information for Supervision, CRIS)
KIBS	Sistemet e Kleringut Ndërbankar
SISX	Sistemi i kalimit të letrave me vlerë që tregohen në tregun sekondar
LP	Pengimi i larjes së parave (Anti Money Laundering)
ARDL	Modeli autoregresiv me vonesa të shpërndara (Autoregressive Distributed Lag Modelling Approach)
IT-SREP	Procesi mbikqyrës i vlerësimit të rrezikut të TI-së (Supervisory Review and Evaluation Process)

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 9) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe nenit 54, paragrafi (1), nënparagrafi (3) i Rregullores për planifikim strategjik dhe operativ Rr. nr. 02-15/I-1/2016 nga 28 janari 2016, Rr. nr. 02-15/VI-1/2020 nga 28 prilli 2020, Rr. nr. 02-15/IX-3/2021 nga 30 qershori 2021 dhe nga nr. 03-23366/5 nga 30 qershori 2023, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

Programin e punës të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Programi i punës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm: Programi i punës) përmban aktivitete programore për arritjen e qëllimeve strategjike të përcaktuara me [Planin Strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022 – 2024](#), PS nr. 02 - 15/ VIII-1/2021 nga 4 qershori 2021.
2. Programi i punës ka për qëllim të sigurojë arritjen e qëllimeve strategjike të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) duke udhëzuar në mënyrë optimale burimet në dispozicion në fushat prioritare, duke forcuar kapacitetet në të gjitha segmentet e punës, duke përmirësuar më tej cilësinë e punës dhe duke mundësuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rezultateve dhe efektivitetin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra.
3. Aktivitetet e programit përfshijnë procese të rregullta pune dhe aktivitete në lidhje me projektet që mundësojnë hyrjen e ndryshimeve në operacione në drejtim të rritjes së efikasitetit, cilësisë, transparencës dhe besueshmërisë, pajtueshmërisë me kërkesat e reja ligjore, rregulloret europiane, standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

AKTIVITETET PROGRAMORE

4. Aktivitet e rregullta programore lidhen drejtpërdrejt me [qëllimet strategjike](#) dhe [detyrat](#) të Bankës Popullore dhe realizohen gjatë gjithë vitit. Shpërndarja e aktiviteteve programore sipas qëllimeve të përcaktuara strategjike dhe bartësve kryhet si në vijim:

Qëllimi strategjik 1 - Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare

Analizat dhe projeksionet makroekonomike të besueshme dhe gjithë përfshirëse janë bazë për kryerjen e politikave makroekonomike në kohë dhe të përshtatshme. Prandaj, Banka Popullore vazhdimisht punon në forcimin dhe përmirësimin e aftësive analitike, përkatësisht në forcimin e kapaciteteve për analiza dhe projeksione makroekonomike, me qëllim të menaxhimit të mëtutjeshëm të suksesshëm të politikës monetare. Për të përmirësuar fuqinë për të shpjeguar lëvizjet ekonomike, janë parashikuar përmirësime të mëtejshme në modelin MAKPAM-së, i cili është bazë për marrjen e vendimeve monetare.

Këto aktivitete, të cilat janë një praktikë e rregullt vjetore, do të kontribuojnë në përmirësimin e fuqisë për të shpjeguar dhe projektuar lëvizjet ekonomike. Gjatë vitit 2024 do të vijojnë

aktivitetet për kontrollin dhe përmirësimin e modeleve aktuale për parashikimin afatshkurtër të PBB-së dhe inflacionit, si dhe për përmirësimin e qasjeve për parashikimin afatshkurtër të kategorive më të rëndësishme të bilancit të pagesave. Prioritet për Bankën Popullore ende është stabiliteti i çmimeve dhe [ruajtja e stabilitetit të kursit të denarit](#). Banka Popullore do të vazhdojë të menaxhojë likuiditetin e sistemit bankar duke përshtatur kornizën operative në pajtim me sfidat e jashtme dhe të brendshme. Në të njëjtën kohë, do të punohet për modernizimin e mëtejshëm të operacioneve monetare dhe planifikimin e likuiditetit. Gjithashtu, do të përmirësohet baza analitike për mbikëqyrjen e efikasitetit të masave të rezervës së detyrueshme. Banka Popullore do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e tregut të brendshëm valutor dhe zhvillimin e brendshëm të [tregjeve financiare](#), aktivitete që do të realizohen përmes bashkëpunimit të ndërsjellë me bankat.

Aktivitet që lidhen me këtë qëllim strategjik janë:

- përgatitja e projeksioneve makroekonomike;
- përgatitja e analizave për qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe të jashtëm, kursin real të balancuar të këmbimit dhe transmetimin monetar, të cilat përdoren në marrjen e vendimeve të politikës monetare;
- kryerja e rregullt e operacioneve monetare dhe ruajtja e ekuilibrit në tregun valutor të denarit;
- Harmonizimi i mëtejshëm i kornizës monetare për menaxhim më efikas të politikës monetare nëpërmjet përmirësimit të kanalit të transmetimit të normave të interesit dhe duke mbështetur procesin e denarizimit
- Përmirësimi i bazës analitike për mbikëqyrjen e efikasitetit të masave në rezervën e detyrueshme;
- Përmirësimi i funksionalitetit të sistemit elektronik të thesarit

Rezultatet e pritura: Forcimi i kapaciteteve dhe përmirësimi i pajisjeve për analizë makroekonomike, parashikim dhe afim drejt praktikave më të mira të vendosura nga institucionet financiare ndërkombëtare. Ndryshime në kohë dhe të duhura në politikën monetare, mbajtje e kursit të këmbimit stabil të denarit dhe stabilitet i çmimeve në afat të mesëm.

Bartës: DPMH dhe DTF

Qëllimi strategjik 2 – Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar

Banka Popullore, si [organ mbikëqyrës](#) që mbikëqyr bankat dhe kursimoret, është e vendosur në angazhimin e saj për zbatimin e mbikëqyrjes efektive mikroprudenciale dhe makroprudenciale. Një nga qëllimet bazë të Bankës Popullore është ruajtja e sigurisë dhe stabilitetit të një sistemi bankar që është rezistent ndaj rreziqeve të jashtme dhe të brendshme. Fokusi kryesor i Bankës Popullore do të jetë i drejtuar në disa fusha kryesore:

1. Përmirësimi i rregullores bankare;
2. Zbatimi i mandatit makroprudencial të Bankës Popullore;
3. Ndjekje të lëvizjeve dhe rreziqeve në sistemin bankar;
4. Përf forcimin e mbikëqyrjes nga jashtë jashtë dhe në terren;
5. Përmirësimin e mjeteve softuerike dhe sistemeve për analiza dhe raporte.

Banka Popullore do të vazhdojë harmonizimin me rregulloren europiane, standardet ndërkombëtare dhe trendet në fushën e rregulloreve bankare. Ky proces synon të harmonizojë rregulloren e brendshme me standardet dhe praktikën më të mira europiane dhe ndërkombëtare. Përveç kësaj, hartimi i një Ligji të ri të Bankave do të sigurojë harmonizim me

dispozitat dhe kërkesat e Ligjit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, të miratuar në tetor të vitit 2023.

Në të njëjtën kohë, do të ndërmerren aktivitete për përmirësimin e mëtejshëm të kornizës rregullore në pajtim me rregulloren e BE-së dhe metodologjitë e Komitetit të Bazelit dhe Autoritetit Bankar Europian, gjë që do të sigurojë forcimin shtesë të rrejtës së sigurisë së sektorit financiar. Gjithashtu, do të bëhet analizë e legjislacionit ekzistues në fushën e sigurisë së informacionit në pajtim me rekomandimet dhe ndryshimet më të fundit të rregullores së BE-së. Vëmendje do t'i kushtohet forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të Bankës Popullore në lidhje me ndryshimet klimatike. Do të përmirësohen praktikat mbikëqyrëse në fushën e vlerësimit të rrezikut të ndryshimeve klimatike nëpërmjet përvetësimit të njohurive dhe aftësive dhe ndryshimeve të duhura në metodologjitë përkatëse.

Banka Popullore do të vazhdojë me vlerësimin dhe analizën e rregullt të rreziqeve sistematike dhe në pajtim me rrethanat do të ndërmerr masa makroprudenciale nëse është e nevojshme. Gjithashtu do të vlerësojë qëndrueshmërinë e sistemit bankar ndaj goditjeve duke kryer teste të rregullta të ndjeshmërisë, testin e makro stresit vjetor dhe në varësi të nevojës do të bëhen testet e stresit të herëpashershme për rreziqe të ndryshme. Në të njëjtën kohë, do të përmirësohen praktikat mbikëqyrëse dhe kuadri metodologjik për përdorimin e testeve të stresit, para së gjithash, në procesin e vlerësimit mbikëqyrës të profilin të rrezikut të bankave. Për të përmirësuar mjetet mbikëqyrëse dhe për të siguruar reagim të shpejtë ndaj rreziqeve të identifikuara, do të vazhdohet me përmirësimin e mëtejshëm të zgjidhjeve të zbatueshme për veprimet mbikëqyrëse. Krahas rreziqeve konvencionale, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rrezikut të TI-së dhe sigurisë kibernetike dhe në të njëjtën kohë, në afat të mesëm do të fillojë zhvillimi i strategjisë mbikëqyrëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Me qëllim të nxitjes së inovacionit dhe konkurrencës në sektorin financiar dhe njëkohësisht përmirësimin e qasjes në shërbimet financiare, Banka Popullore do të kryejë disa aktivitete që synojnë të mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit vendor fintek.

Rezultatet e pritura: Sistem bankar që është i qëndrueshëm, rezistent ndaj rreziqeve të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm. Korniza rregulluese e cila mundëson sistem bankar tregtar dhe konkurues, në pajtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare më të mira.

Bartës: DRB, DFM, ZMI, DMJL, DTM, GP për mbështetjen e sektorit të fintekut

Qëllimi strategjik 3 – Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve pagesore të sigurt, inovative dhe efikase

Për të përmbushur qëllimin e tretë strategjik, Banka Popullore edhe gjatë 2024, do të vazhdojë të mbikëqyr zbatimin e kornizës së re ligjore në sferën e pagesave, e cila për të mbështetur pagesat e popullit dhe sektorin e korporatave, mundëson futjen e teknologjive dhe inovacioneve të reja. Paralelisht, do të vazhdojë me mbikëqyrjen e ndërmjetme dhe të drejtpërdrejtë të [sistemeve pagesore](#) për të mbështetur ekzekutimin e sigurt dhe efikas të pagesave dhe harmonizimin e mëtejshme me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare në këtë fushë. Gjithashtu aktivitetet do të vazhdojnë edhe për përmirësimin e mëtejshëm të punës në sfond në pajtim me praktikat dhe standardet e punës të Bankës Qendrore Europiane dhe forcimin e procedurave dhe sistemeve operacionale që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Banka Popullore edhe më tutje do të vazhdojë të ndërmarrë aktivitete për ruajtjen e sigurisë, stabilitetit dhe efikasitetit të shlyerjes së transaksioneve të lidhura për shkak të zbatimit të politikës monetare dhe menaxhimit të rezervave devizore. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet aktiviteteve të projektit për përmirësimin e zgjidhjeve softuerike të krijuara në shërbimet pagesore dhe sistemet pagesore me qëllim rritjen e transparencës dhe krahasueshmërisë së shërbimeve, për konkurrencë më të madhe dhe mbrojtjes së konsumatorit. Banka Popullore do të vazhdojë me analizat fillestare

të mundësive, përparësive dhe rreziqeve të mundshme nga emetimi i valutës digjitale, denarit digjital, si formë digjitale e monedhës sonë sovranë, denarit.

Disa nga aktivitetet në fushën e këtij qëllimi strategjik janë:

- Strategjia për zhvillimin e sistemit pagesor në RMV si dhe përgatitje dhe miratim të Planit të veprimit për zbatimin e strategjisë;
- Mbikëqyrja e rregullores së re të zbatuar në fushën e shërbimeve pagesore dhe sistemeve pagesor;
- Mbikëqyrja e sistemeve pagesore;
- Projekte për zhvillim dhe përmirësim të zgjidhjeve aplikative në fushën e sistemeve pagesore dhe për zhvillim të shërbimeve pagesore;
- Projekt për implementim të denarit digjital;
- Pjesëmarrje në aktivitetet e Këshillit për bashkëpunim rajonal.

Rezultatet e pritura: Rritje të sigurisë, stabilitetit dhe efikasitetit të sistemit pagesor, përfshirje më të madhe dhe mbrojtje më të mirë të përdoruesve të shërbimeve pagesore. Shfaqja e ofruesve të ri të shërbimeve në treg, siç janë institucionet pagesore, institucionet për para elektronike dhe operatorët e ri të sistemeve pagesore, si dhe rritjen e shkallës së digjitalizimit të shoqërisë.

Bartës: DSP, GP për denarin digjital

Qëllimi strategjik 4 – Përmirësimi i politikës investuese dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave devizore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit.

Banka Popullore menaxhon me rezervat devizore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat janë me interes kombëtar për gjithë ekonominë vendase. Në pajtim me detyrat e saj ligjore, Banka Popullore synon që me efikasitet të menaxhojë me rezervat valutore, me një balancë optimale ndërmjet parimeve të sigurisë, likuiditetit dhe kthimit nga menaxhimi. Gjatë vitit 2024, për të funksionalizuar alokimin e investimeve të rezervave valutore, është parashikuar testimi dhe zbatimi i kuadrit intuitiv për analizë dhe vlerësimin e lëvizjeve të ardhshme në tregjet financiare ndërkombëtare dhe dhe çmimet e instrumenteve individuale financiare. Në këtë kontekst, në mënyrë të rregullt do të kryhet rishikim dhe kalibrimi i faktorëve të përzgjedhur. Vlerësimi sasior që do të rezultojë nga analizat e bëra në pajtim me shkallën e pikës do të jetë një nga elementët hyrës në marrjen e vendimeve për pozicionimin taktik të portofoleve të rezervave valutore.

Disa nga aktivitetet në fushën e këtij qëllimi strategjik janë:

- Menaxhimi me rezervat valutore;
- Zbatimi i kornizës së vendosur për parashikime afatshkurta për lëvizjet e tregjeve financiare në bazë të treguesëve të përzgjedhur tregu/makroekonomik(shkalla e pikëve);
- Zgjerimi i fushës së aplikimit të një modeli të ri biznesi në administrimin e rezervave valutore
- Rishikimi i kuadrit për përcaktimin e kufijve të ekspozimit të rezervave valutore

Rezultatet e pritura: Menaxhim efikas me rezervat valutore të Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë baraspeshës optimale mes parimeve të sigurisë, likuiditetit dhe kthimit nga investimi.

Bartës: DTF

Qëllimi strategjik 5- Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore

Banka Popullore në vazhdimësi ndjek dhe kontribuon në përcaktimin strategjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për integrim në institucionet europiane. Edhe gjatë periudhës së ardhshme, do të marrë pjesë aktive në proceset integruese europiane duke kontribuar në përgatitjen dhe zbatimin e të gjitha dokumenteve strategjike, përfshirë raportet nga grupimet (klasteret) në të cilat Banka Popullore ka qenë e përfshirë në kuadër fazes bilaterale të shqyrtimit analitik të legjislacionit me BE-në, si dhe programeve të rregullta të reformave ekonomike. Banka Popullore edhe më tej do të vazhdojë me harmonizimin e punës së saj dhe me zbatimin aktiv të rregulloreve, standardeve dhe praktikave europiane.

Gjithashtu, Banka Popullore do të vazhdojë me politikën e saj të bashkëpunimit të hapur dhe shkëmbimit të përvojave dhe informacioneve me të gjitha institucionet financiare ndërkombëtare në kuadër të të cilave bashkëpunon Banka Popullore. Në pajtim me qëllimet dhe politikat e punës së saj, Banka Popullore në mënyrë aktive do të mbikëqyr dhe përmbushë obligimet që dalin nga anëtarësimi në institucionet financiare ndërkombëtare.

Disa nga aktivitetet në fushën e këtij qëllimi janë:

- Aktivitete lidhur me procesin e anëtarësimit të BPRMV-së në Sistemin Europian të Bankave Qendrore (paraqitja e raporteve të rregullta, pjesëmarrje në takime të rregullta në kuadër të procesit integrues;
- aktivitete për zbatimin e reformave dhe rekomandimeve lidhur me procesin eurointegrues ¹ në pajtim me raportet zyrtare nga institucionet e BE-së (Raporti për Republikën e Maqedonisë së Veriut, Programi për reforma ekonomike, raporte për grupe (klasteret) në të cilat ka qenë e përfshirë Banka Popullore
- aktivitete për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit statistikor të Bankës Popullore në pajtim me kërkesat dhe standardet e BE-së (vendosja e sistemit të raportimit të integruar nga Banka Popullore, bankat, kursimoret, për qëllime statistikore dhe mbikëqyrëse (ISIDORA); dërgimi i të dhënave ponderuara të normave të interesit për BQE-në, në pajtim me kërkesën për transferimin e të dhënave, aktivitetet për krijimin e sistemit për menaxhimin, ruajtjen, përpunimin dhe trajtimin e të dhënave statistikore, ngritjen e një magazine të dhënash, pjesëmarrjen në projektin IPA të EShS-së për tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve);
- forcimi i kapaciteteve përmes shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunimit me bankat e tjera qendrore;
- bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare.

Rezultatet e pritura: Harmozim me të drejtën e Bashkimit Europian (acquis communautaire) brenda fushave në të cilat merr pjesë Banka Popullore. Përforcimi i kapacitetit analitik, shkëmbimi i përvojave dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të Bankës Popullore.

Bartës: KG, DS, ZKM

Qëllimi strategjik 6- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies

Banka Popullore përpaket për përmirësimin e vazhdueshëm të [transparencës dhe llogaridhënies](#) në punën e saj. Në kuadër të aktiviteteve për [informimin e publikut](#), Banka Popullore do të përdor një qasje të sistemuar për komunikim, që do të mundësojë disponueshmërinë dhe shpërndarjen në kohë të informatave dhe të dhënave të nevojshme, edhe atë me arsyetim adekuat për masat e ndërmarra. Do të vazhdohet me informimin e publikut për mesazhet dhe vështrimet që dalin nga diskutimet me ekspert të njohur dhe përfaqësues të komunitetit bankar qendror për çështjet aktuale në fushën e politikës monetare dhe të sistemit financiar. Banka Popullore do t'i kushtojë vëmendje të veçantë përforcimit të mëtejshëm të mekanizmave për mbikëqyrjen e informacioneve që mund të ndikojë në opinionin publik në lidhje me punën e

¹ Këto aktivitete i referohen disa fushave të veprimtarisë së Bankës Popullore dhe më detajisht janë renditur në kuadër të objektivave të veçanta strategjike.

Bankës Popullore ose në lidhje me stabilitetin monetar dhe financiar. Banka Popullore do të vazhdojë me përmbushjen e [Planit Strategjik](#) nëpërmjet zbatimit të suksesshëm të aktiviteteve dhe projekteve të planifikuara, ndërsa po planifikohet përmirësimi i procesit të mbikëqyrjes dhe prezantimit të realizimit të aktiviteteve programore. Gjatë vitit 2024, Banka Popullore do të fillojë procesin e përgatitjes dhe miratimit të Planit të ri Strategjik të Bankës Popullore për periudhën 2025-2027, me të cilin do të definohen qëllimet e ardhshme strategjike, fushat dhe drejtimet në të cilat do të veprojnë në tre vitet e ardhshme. Gjithashtu, Banka Popullore do të vazhdojë me zbatimin e standardeve më të larta për transparencë dhe qartësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore për [raportimin financiar dhe funksionimin e bankës qendrore](#). Në kuadër të këtij qëllimi strategjik, të rëndësishme janë edhe aktivitetet që do të ndërmerren për avancimin e proceseve për planifikim, realizim dhe për mbikëqyrjen e [prokurimeve publike](#), zhvillimin e [punës muzeale](#), punës kërkimore, [veprimtaritë bibliotekare dhe historiko-arkivore](#) si kontribut në promovimin e vlerave kombëtare dhe shoqërore.

Disa nga aktivitetet në fushën e këtij qëllimi strategjik janë:

- Planifikim strategjik;
- Publikimi i raporteve financiare vjetore të BPRMV-së dhe mendimi nga revizori i jashtëm;
- Komunikimi me opinionin publik dhe thellimi i bashkëpunimit me mediat si hallkë e pare e transferimit të informacioneve;
- Planifikimi i nevojave për prokurim publik, analiza dhe mbikëqyrja e zbatimit të Planit vjetor të prokurimit publik;
- Punë me fondin e bibliotekës dhe realizimin e parapagimit në gazeta dhe baza të të dhënave;
- Digjitalizimi i materialit arkivor me rëndësi historike;
- Punë muzeale me koleksionin, puna kërkimore dhe edukimi muzeor.

Rezultatet e pritura: Informimi më i madh për qëllimet edhe detyrat e Bankës Popullore dhe realizimit të vizionit të njihet si institucion i pavarur, i përgjegjshëm, profesional, inovativ dhe transparent e cila gëzon besim dhe kredibilitet të lartë në publik.

Bartës: KG, ZPP, DFKK, DPP, Muzeu, Biblioteka dhe Arkiva

Qëllimi strategjik 7- Edukimi financiar dhe përfshirja

Përforcimi i [edukimit financiar](#) të popullsisë, avancimi i shkallës së përfshirjes financiare dhe sigurimi i mbrojtjes së duhur të konsumatorit, janë fushat kryesore në të cilat Banka Popullore do të vazhdojë të punojë me përkushtim për të arritur këtë qëllim strategjik. Janë paraparë më shumë aktivitete edukative që do të sigurojnë ngritjen e vetëdijes dhe edukimit financiar dhe do të mundësojnë një shkallë më të lartë të përfshirjes financiare të popullatës. Fokusi i këtij qëllimi strategjik do të jetë zbatimi i [Strategjisë së edukimit financiar dhe përfshirjes financiare të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2025](#). Aktivitetet do të zhvillohen në bashkëpunim me rregullatorë të tjerë financiarë në kuadër të Trupit koordinues të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare, si dhe me subjekte të tjera nga sektori privat dhe civil. Banka Popullore gjatë vitit 2024 do të jetë proaktive edhe në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Me këtë do të kontribuojë në forcimin e sistemeve të mbrojtjes së konsumatorit në sistemin bankar, me qëllim forcimin e besimit të qytetarëve në sektorin bankar, i cili është kryesor për stabilitetin e qëndrueshëm financiar.

Disa nga aktivitetet në fushën e këtij qëllimi strategjik janë:

- Edukimi financiar dhe organizimi i ngjarjeve për edukimin e publikut (Java globale e parasë, Punëtori - trajnim për trajnimin e mësuesve, Ditët e edukimit financiar, Dita Botërore e Kursimeve);

- Zbatimi i Strategjisë së edukimit financiar dhe përfshirjes financiare të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2025;
- Punëtori dedikuar grave sipërmarrëse në fushën e edukimit financiar dhe përfshirjes financiare në bashkëpunim me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh);
- Zbatimi i kontrolleve në terren dhe përgatitja e raporteve të rregullta për llojin e ankesave dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre nga bankat dhe kursimoret;
- Aktivitete të mëtejshme në lidhje me shqyrtimin dhe harmonizimin e projektligjit për Avokatin e Popullit financiar me rregullatorët e tjerë financiarë;
- Rishikimi dhe avancimi i legjislacionit ekzistues me qëllim forcimin e sistemit të mbrojtjes së konsumatorit në sistemin bankar.

Rezultatet e pritura: Rritja e vetëdijesimit dhe edukimit financiar të popullsisë, përmirësimin e shkallës së përfshirjes financiare dhe forcimin e sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve.

Bartës: DMKEF

Qëllimi strategjik 8- Rritja e vetëdijës për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër

Banka Popullore si institucion me përgjegjësi shoqërore edhe më tej do të vazhdojë të ndërmarrë hapa konkrete për të menaxhuar në mënyrë aktive rreziqet e ndryshimeve klimatike, për të forcuar qëndrueshmërinë dhe kapacitetet e sistemit bankar për administrimin e rreziqeve klimatike, por edhe për të rritur potencialin për të mbështetur transformimin e gjelbër të ekonomisë.

Plani afatmesëm i miratuar për aktivitetet e Bankës Popullore në fushën e menaxhimit të rreziqeve lidhur me ndryshimet klimatike për periudhën 2023 - 2025 parasheh ndërmarrjen e disa aktiviteteve në periudhën që vijon, si: ndjekja e standardeve ndërkombëtare në fushën e rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike dhe ndryshimet e duhura në kuadrin rregullator ekzistues, mbajtja e një konference për financat e gjelbra, analiza e ndikimit të rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike në operacionet e bankave vendase dhe kryerja e testeve të stresit për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Parashikohen edhe aktivitete për ndryshimin e qasjes mbikëqyrëse, me përfshirjen graduale aktive të rreziqeve klimatike gjatë vlerësimit të profilit të rrezikut të bankave.

Në periudhën e ardhshme do të vazhdohet me bashkëpunimin aktiv kombëtar dhe ndërkombëtar, hartimin e duhur të aktiviteteve analitike dhe hulumtuese, por edhe ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, kulturës korporative dhe qëndrueshmërisë së operacioneve të Bankës Popullore. Do t'i kushtohet vëmendje edhe koordinimit të aktiviteteve në vend dhe nevojës për bashkëpunim me institucione dhe organe tjera shtetërore, duke pasur parasysh se çështjet klimatike kërkojnë një qasje të koordinuar kombëtare. Sa i përket menaxhimit të rezervave valutore, Banka Popullore do të shqyrtojë mundësitë e veçimit të një portofoli të veçantë të obligacioneve të gjelbra dhe do të kryejë përgatitje analitike për të matur rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe për të paraqitur efektet e investimit në bono të gjelbra.

Disa nga aktivitetet në fushën e këtij qëllimi strategjik janë:

- Mbikëqyrje e standardeve ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të bankave me rreziqe që rrjedhin nga ndryshimet klimatike dhe perceptim i mundësisë së zbatimit të tyre në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Mbikëqyrja e rreziqeve nga ndryshimet klimatike;
- Përpunimi i një metodologjie të brendshme, gjegjësisht procedurë për vlerësimin e rreziqeve në banka në lidhje me ndryshimet klimatike;
- Organizimi i një konference për financat e gjelbraë
- Kontribut në punën e rrjetit të sistemit financiar të gjelbër;

- Shqyrtimi i mundësisë për të ndarë mënjatë portofol të veçantë të obligacioneve të gjelbra;
- Rishikimi i parametrave për matjen e rrezikut të ndryshimeve klimatike në administrimin e rezervave valutove dhe efektin e investimeve në obligacionet "gjelbër" në përmirësimin e mjedisit

Rezultatet e pritura: Vetëdijësimi i rritur për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër dhe kushte më të mira jete të qytetarëve.

Bartës: DRrZB, DFM, DTM, DTF dhe ZKM

Qëllimi strategjik 9 - Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore

Banka Popullore si institucion me funksione dhe detyra me interes publik do të vazhdojë me aktivitetet për [menaxhimin e rreziqeve](#) në të gjitha segmentet e punës së saj me qëllim të arritjes së qëllimeve strategjike duke respektuar standardet më të larta për [udhëheqjen e korporatës](#).

Për të përmirësuar rrjedhën e zbatimit të proceseve të punës dhe cilësinë në realizimin e detyrave të punës janë planifikuar aktivitete për forcimin e mekanizmave të menaxhimit për kontrollin e brendshëm të rreziqeve, si dhe aktivitete të rregullta në fushën e [revizionit të brendshëm](#), si dhe analizë efektit në aktet e brendshme dhe punën e auditimit të brendshëm në pajtim me standardet e reja për auditimin e brendshëm. Banka Popullore do të marrë masa për të forcuar [sigurinë e sistemit informativ](#), rezistencën ndaj kërcënimeve kibernetike dhe sigurimi i vazhdimësisë së biznesit, mbrojtja e të dhënave personale dhe siguria e informacionit të klasifikuar. Gjithashtu do të vazhdohet me avancimin e harmonizimit në Bankën Popullore, respektivisht mbajtjes në nivel të lartë të [punës në pajtim me ligjin dhe etikën](#) gjatë zbatimit të qëllimeve dhe detyrave të Bankës Popullore nga anëtarët e Këshillit dhe punonjësit e Bankës Popullore, angazhimin për forcimin e mëtejshëm të integritetit të Bankës Popullore dhe menaxhimin e duhur të rreziqeve të mundshme nga mos përputhshmëria. Njëkohësisht, do të vazhdojnë aktivitetet për forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e rrezikut ligjor, si dhe avancimi i mëtejshëm i masave të sigurisë dhe sigurisë gjatë punës. Banka Popullore parasheh aktivitete për avancimin e procesit të planifikimit operativ, analizim të gjendjes financiare dhe raportit të ardhurave dhe realizimin e planit financiar, si dhe zbatimin e mëtejshëm të projektit për futjen e sistemit të integruar të kontabilitetit si mekanizëm për mbrojtjen nga rreziqet e shtuara gjatë punës.

Në plani janë edhe aktivitetet për ndryshimin e politikave dhe rregullave të kontabilitetit në pajtim me ndryshimet e propozuara në kuadrin ligjor pas rekomandimeve të marra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Qendrore Europiane (BQE), me qëllim forcimin e menaxhimit korporativ dhe pozitën e kapitalit të Bankës Popullore me qëllim të mbrojtjes nga rreziqet e shtuara dhe sigurimin e shkallës më të madhe të pavarësisë financiare të Bankës Popullore.

Disa nga aktivitetet në fushën e këtij qëllimi strategjik janë:

- Udhëheqja me rreziqet operative dhe ngritjen e vetëdijës dhe kulturës së punonjësve për menaxhim me rreziqet operative nga funksionimi i përditshëm;
- Kryerja e auditimeve të bazuara në rrezik që ofrojnë garanci të arsyeshme për menaxhimin e rreziqeve operacionale, sistemin e kontrolleve të brendshme dhe menaxhimin korporativ të Bankës Popullore, me qëllim që t'i jepet vlerë dhe të përmirësohen operacionet;
- Përforcimi i mëtejshëm i sigurisë së sistemit të informacionit dhe përmirësimi i masave për qëndrueshmërinë kibernetike dhe qëndrueshmërinë operacionale, këshillimin dhe trajnimin e rregullt të punonjësve për një rol aktiv në mbrojtjen e sistemit të informacionit, të dhënave personale dhe informacionit të klasifikuar, duke përfshirë

kontrollat periodike të pajtueshmërisë së operacioneve me rregulloren e fushës së sigurisë së sistemit të informacionit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacioneve të klasifikuara;

- Përditësimi dhe testimi i realizueshmërisë së planeve për vazhdueshmëri të proceseve kritike të punës në skenarë të krizës;
- Avancimi i pajtueshmërisë në nivel të Bankës Popullore përmes informimit dhe këshillimit në lidhje me rregulloren e pajtueshmërisë, kryerja e aktiviteteve edukative për të promovuar, para së gjithash, respektimin etik të punonjësve dhe anëtarëve të Këshillit të Bankës Popullore gjatë kryerjes së detyrave/veprimtarive të tyre të punës, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të mospajtueshmërisë, më konkretisht rreziqet e korrupsionit;
- Përgatitja e dokumentacionit përkatës me udhëzime të propozuara për vazhdimin e aktiviteteve për ndërtimin e objektit të ri;
- Zbatim i mëtejshëm i projekteve që përmirësojnë sistemin e kontabilitetit të Bankës Popullore, përkatësisht: krijimi i një sistemi të ri të integruar të kontabilitetit ISS- libri kryesor si dhe më shumë zgjidhje dhe përmirësime aplikative të kontabilitetit
- Përgatitja e ndryshimeve në politikat kontabël të Bankës Popullore dhe rregullat e kontabilitetit për regjistrim, të cilat kanë të bëjnë me ndryshimet e propozuara në Ligjin për Bankën Popullore, në pjesën e kapitalit, rezervave, shpërndarjes së fitimit dhe mbulimit të humbjeve

Rezultatet e pritura: Udhëheqje efektive me rreziqet në të gjitha segmentet e funksionimit për arsye të qëllimeve strategjike, për forcimin e masave kontrolluese dhe uljen e rreziqeve tjera, përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë të Bankës Popullore.

Bartësit: ZSP, DAB, DFKK, DPJ dhe DMTS

Kapaciteti institucional 1 - Integriteti dhe besimi në njësinë monetare kombëtare

Gjatë vitit 2024, Banka Popullore si bankë e vetme emetuese do të vazhdojë me aktivitetet për ruajtjen e integritetit dhe besimit në [njësinë monetare kombëtare](#) nëpërmjet funksionalitetit, stabilitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të vendosur të sistemit të furnizimit me cash dhe sigurimit të cilësisë së lartë standarde të parave të letrës dhe monedhave në qarkullim.

Pjesë e aktiviteteve të kësaj fushe janë:

- Prodhimi/prokurimi i parave të letrës dhe monedhave, kambialeve, parave të përshtatshme dhe monedhave për qëllime koleksionimi;
- Furnizimi i bankave dhe qendrave të parave të gatshme me para të letrës dhe monedha;
- Mbikëqyrja e furnizimit me para të letrës dhe monedha në banka dhe qendra të parasë së gatshme;
- Zëvendësimi i parave të letrës dhe monedhave të dëmtuara të personave fizik për të ruajtur cilësinë e parave në qarkullim dhe për të ruajtur reputacionin e Bankës Popullore;
- Kryerja e analizave profesionale dhe ekspertizës së parave të dyshimta me qëllim zbulimin e saktë dhe efikas të parave të falsifikuara dhe parandalimin e prodhimit dhe shpërndarjes së mëtejshme të falsifikateve;
- Kryerja e procedurave të rregullta të testimit të makinerive të përpunimit të letrës dhe monedhave sipas dinamikës së përcaktuar kohore;
- Zbatimi i një platforme të standardizuar për trajnimin e stafit të bankave për të kontrolluar vërtetësinë dhe përshtatshmërinë e parave në qarkullim;

- Realizimi i planit kombëtar për trajnim në pajtim me rekomandimet e projektit të binjakëzimit "Përforcimi i kapaciteteve të sistemit për të luftuar falsifikimin e euros";
- Përmirësimi i proceseve dhe sistemeve për trajtimin e njësive monetare, duke reduktuar rreziqet e gabimeve dhe lëshimeve, prezantimi i moduleve të reja për funksionim të automatizuar dhe bashkëpunim më efikas me institucionet e tjera shtetërore.

Rezultatet e pritura: Ruajtja e nivelit të lartë të integriteti dhe besimit në njësinë monetare kombëtare.

Bartës: DOTh

Kapaciteti institucional 2 - Burimet njerëzore

Sigurimi dhe zhvillimi i potencialit njerëzor modern dhe kompetent, i adaptueshëm ndaj ndryshimeve të shpejta në mjedis, është një parakusht themelor për realizimin efektiv dhe efikas të mandatit tonë si bankë qendrore dhe për përmbushjen e misionit tonë për mirëqenien e publikut në përgjithësi. [Punonjësit janë potenciali më i madh i Bankës Popullore](#), për shkak se edhe më tej do të punohet në tërheqjen, mbajtjen dhe zhvillimin e personelit të përkushtuar. Gjithashtu do të vazhdohet me aktivitetet për tu kujdesur për mjedisin pozitiv të punës dhe kulturën e korporatës e cila inkurajon bashkëpunimin, shpirtin e ekipit, profesionalizimin dhe kreativitetin.

Pjesë e aktiviteve të kësaj fushe janë:

- Vendosja e një organizimi të përshtatshëm organizativ dhe sistematizues;
- Rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës;
- Sigurimi i angazhimit të punonjësve;
- Formimi dhe zhvillimi profesional i punonjësve.

Rezultatet e pritura: Potencial njerëzor të kualifikuar, kompetent dhe të përkushtuar që mund të përshtaten shpejt me sfidat e jashtme të cilat janë gjithnjë në ndryshim është element thelbësor për arritjen e misionit dhe vizionit të Bankës Popullore dhe realizimin e qëllimeve të synuara. Respektimi i parimeve dhe cilësive të vendosura të organizatës, duke përfshirë: cilësinë, integritetin, besnikërinë, transparencën, udhëheqjen, inovacionin, fleksibilitetin, profesionalizmin dhe punën në grup.

Bartës: DBNj

Kapaciteti institucional 3- Sistemi informativ

Sistemi informativ i Bankës Popullore është një sistem kompleks që përmban pajisje të ndryshme informative dhe komunikuese dhe një numër të madh të të dhënave në formate të ndryshme, duke mbështetur proceset afariste në bankë gjatë kryerjes së aktiviteve të ndryshme ditore dhe kritike. Prandaj, Banka Popullore do të vazhdojë të sigurojë stabilitetin e sistemit informativ dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij me harduerin dhe softuerin më të fundit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare, duke arritur një shkallë të lartë të disponueshmërisë dhe sigurisë së informacionit në sistem. Gjatë vitit 2024, Banka Popullore do të vazhdojë me mirëmbajtjen e rregullt të aplikacioneve të zhvilluara nga brenda, përmirësimin e funksionalitetit të tyre, si dhe zhvillimin e zgjidhjeve të reja aplikative me qëllim të përmirësimit të veprimtarisë në bankë, pajtueshmërinë me ndryshimet në aktet ligjore dhe të brendshme dhe zgjidhjen në kohë të incidenteve për të siguruar funksionimin e pandërprerë të sistemeve. Disa nga aktivitetet përfshijnë heqjen e gjetjeve që shfaqen gjatë testimit të penetrimit, testimit të brendshëm, si dhe gjetjeve nga auditimi i brendshëm. Njëkohësisht do

të vazhdojë digjitalizimi për të lehtësuar proceset e brendshme dhe për të rritur efikasitetin dhe produktivitetin, gjë që është bazë për arritjen me sukses të qëllimeve strategjike.

Pjesë e aktiviteteve të kësaj fushe janë:

- Menaxhimi i incidenteve të TI-së;
- Zhvillimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e aplikacioneve;
- Vendosja e një mjeti për ruajtjen e kodit burimor për bazat e të dhënave;
- Vendosja e një mjeti për testim statik të aplikacioneve, mjet dhe shërbime për testim dinamik dhe shërbime për analiza forenzike të incidenteve të TI-së;
- Vendosja e SOC (Qendra Operative e Sigurisë nga fusha e TI-së);
- Testime të rregullta vjetore të penetrimit dhe kontrole të cënueshmërisë;
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së TI;
- Vendosja e shërbimeve të TI-së.

Rezultatet e pritura: Ruajtja e stabilitetit të sistemit të informacionit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i tij me harduerin dhe softuerin më të fundit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare, duke garantuar një shkallë të lartë disponueshmërie dhe sigurie të sistemeve të informacionit dhe TI-së.

Bartës: STI- Sektori i Teknologjisë Informative, DTI – Drejtoria e Infrastrukturës së TI-së, DAP- Drejtoria e Aplikacioneve dhe Njësia e Mbikëqyrjes dhe Sigurisë së TI-së

Kapaciteti institucional 4- Të dhëna statistikore

Të dhënat statistikore të cilat mbledhen dhe analizohen nga Banka Popullore janë të një rëndësie të madhe për mbarë publikun dhe luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e proceseve në Bankën Popullore në marrjen e vendimeve me kohë dhe cilësore. Për të përmirësuar cilësinë dhe saktësinë e këtyre të dhënave, Banka Popullore do të vazhdojë të zhvillojë mundësitë për mbledhjen, analizimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Gjithashtu, Banka Popullore do të mbetet plotësisht e përkushtuar në përmbushjen e obligimeve të saja ndaj partnerëve ndërkombëtarë në fushën e statistikave dhe do të punojë në harmonizimin e të dhënave me standardet dhe praktikën më të larta botërore.

Pjesë e aktiviteteve të kësaj fushe janë:

- Publikimi i të dhënave nga fusha e statistikës monetare dhe eksterne, statistika e llogarive financiare dhe letrave me vlerë, si dhe përmbushja e obligimeve të raportimit të cilat vijnë nga anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare;
- Aktivitete për pasurimin e grupit të të dhënave statistikore të disponueshme për përdoruesit
- Përmirësimi i të dhënave në bilancin e pagesave dhe PIN-së duke përcaktuar propozim të metodologjisë së re për transfertat private dhe para në valutë jashtë sistemit bankar;
- Racionalizimi i procesit të mbledhjes së të dhënave për investimet në dhe nga jashtë dhe aktivitetet kreditore me vendet e jashtme përmes implementimit të njoftimit elektronik.

Rezultatet e pritura: Përgatitja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore cilësore, në kohë dhe lehtësisht të qasshme, të përpunuara në pajtim me standardet relevante kombëtare dhe ndërkombëtare, duke marrë në këtë mënyrë të dhëna të kompatible, të krahasueshme me sistemet statistikore ndërkombëtare.

Bartës: DS-ja

Kapaciteti Institucional 5 – Veprimtaria hulumtuese

Banka Popullore do të vazhdojë me mbështetjen dhe promovimin e aktiviteteve të saja kërkimore dhe do të kontribuojë në promovimin dhe pasurimin e veprimtarisë shkencore dhe kërkimore në nivel vendor dhe ndërkombëtar. [Aktivitetet hulumtuese](#) janë pasqyruar në disa [publikime](#): raporte të rregullta, shtojca analitike brenda raporteve, materiale pune, analiza, si dhe materiale të tjera. Në vitin 2024 fokusi do të jetë në fushat kryesore për arritjen efektive të qëllimeve dhe zbatimin e politikave të Bankës Popullore.

Gjithashtu, në mënyrë të rregullt do të vazhdojë organizimi i sesioneve të rregullta tremujore të [Klubit të Hulumtuesve](#), si një mundësi për të shkëmbyer përvoja me publikun në fushën e makroekonomisë dhe tema të tjera të operacioneve të bankës qendrore.

Gjatë vitit të ardhshëm pritet vazhdimi i aktiviteteve tashmë të nisura me qëllim rrumbullaksimin e tyre, e që i referohen fushave përkatëse, siç janë kanalet dhe intensiteti i transmetimit nga çmimet botërore në ato vendase, marzhet e fitimit, procesi i formimit të pagave dhe çmimeve nga ana e sektorit korporativ vendor, etj. Aktivitetet e reja brenda fushës kërkimore që duhet të fillojnë në vitin e ardhshëm kanë të bëjnë me temat e mëposhtme:

- Përmirësimi i modelit të analizës së politikave në ekonominë e brendshme (MAKPAM);
- Çmimet e naftës dhe ushqimeve në Maqedoninë e Veriut: qasja jolineare ARDL

Rezultatet e pritura: Inkurajimi i hulumtimeve në fusha të ndryshme ekonomike dhe debatit akademik për të mbështetur procesin e vendimmarrjes në fushën e politikës monetare dhe stabilitetit financiar.

Bartës: DPMH-ja

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

5. Programi i punës realizohet gjatë një viti kalendarik, duke filluar nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2024.

Pjesë përbërëse e Programit të Punës janë shtojca 1 – Aktivitete të rregullta programore, shtojca 2 – Projekte nga fusha të caktuara në punën e Bankës Popullore, shtojca 3 – Organizimi i ngjarjeve dhe shtojca 4 – Projektet për zhvillim të softuerit.

6. Programi i punës hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 02-38910/3
30 nëntor 2023
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

Shtojca 1

AKTIVITETET E RREGULLTA PROGRAMORE		
Nr. rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
QS1 Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare		
1	DPMH	Përgatitja e projeksioneve makroekonomike
2	DPMH	Përgatitja e analizave për qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe të jashtëm, kursi real i këmbimit i balancuar dhe transmetimi monetar që përdoren në marrjen e vendimeve të politikës monetare
3	DPMH	Hulumtim anketues
4	DPMH	Përgatitja e analizave ad hoc me kërkesë të udhëheqësisë
5	DPMH	Përpunimi i raporteve të rregullta
6	DTF	Kryerja e rregullt e operacioneve monetare dhe ruajtja e stabilitetit në kursin e denarit
7	DTF	Harmonizimi i mëtejshëm i kornizës monetare në pajtim me rekomandimet nga bashkëpunimi teknik me FMN-në për modernizimin e operacioneve monetare dhe planifikimin e likuiditetit
8	DTF	Pjesëmarrja dhe mbështetja e zhvillimit të tregjeve të brendshme financiare
9	DTF	Përmirësimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i tregut valutor, në pajtim me rekomandimet e bashkëpunimit teknik me FMN-në
10	DTF	Përmirësimi i kornizës operative për miratimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme
QS2 Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezitencës së sistemit bankar		
11	DRB	Përfundimi i përgatitjes së Ligjit për bankat dhe përgatitja e akteve nënligjore përkatëse në bazë të këtij ligji
12	DRB	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore bazuar në Ligjin për zgjidhjen e çështjeve të bankave
13	DRB	Mbikëqyrja e standardeve dhe prirjeve ndërkombëtare në fushën e rregullimit bankar dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme (BE, standardet e Bazelit, vendet e rajonit etj.)
14	DRB	Pjesëmarrja në hartimin e projektligjeve të tjera ligjore, ose në përgatitjen e projekt-amendamenteve dhe plotësimit në aktet ligjore ekzistuese
15	DRB	Ndryshime dhe plotësime në rregulloret tjera bankare
16	DRB	Aktivitete të tjera të rregullta lidhur me rregullimin bankar dhe detyrat e punës së Drejtorisë
17	DFM	Mbikëqyrja e lëvizjeve dhe rreziqeve në sistemin bankar
18	DFM	Mbikëqyrja e lëvizjeve dhe rreziqeve në sistemin financiar
19	DFM	Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sistemit bankar ndaj goditjeve
20	DFM	Mbikëqyrja e nevojës dhe kushteve për vendosjen/lirimin e masave makroprudenciale dhe mbikëqyrja e efekteve të masave makroprudenciale të prezantuara
21	DFM	Transparenca

AKTIVITETET E RREGULLTA PROGRAMORE		
Nr. rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
22	DFM	Pjesëmarrja në projekte/grupe pune
23	DFM	Aktivitete të tjera të rregullta
24	ZMI	Kontrolle të rregullta mbikëqyrëse në terren
25	ZMI	Aktivitete të rregullta në terren
26	ZMI	Krijimi i një regjistri për mbikëqyrjen e lëvizjes së vlerësimeve nga vlerësimi vjetor i kryer IT-SREP
27	ZMI	Analiza e legjislacionit ekzistues në fushën e sigurisë së informacionit në pajtim me rekomandimet dhe ndryshimet më të fundit të rregulloreve të BE-së në këtë fushë
28	DMJL	Aktivitete të rregullta në terren
29	DMJL	Forcimi i kapaciteteve të mbikëqyrësve për rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike dhe zbatimi i Planit afatmesëm të aktiviteteve të Bankës Popullore në fushën e menaxhimit të rrezikut lidhur me ndryshimet klimatike për periudhën 2023 - 2025
30	DMJL	Forcimi i kapaciteteve të Bankës Popullore në lidhje me procesin e testimit të stresit nga poshtë lart (angl. Bottom up stress test) dhe ndryshimin e tij në vlerësimin e SREP dhe përcaktimin e kërkesës për kapital
31	DMJL	Zbatimin e aktiviteteve për tejkalimin e dobësive të përcaktuara me Raportin "Manival" për Maqedoninë
32	DMJL	Realizimi i kontrolleve në terren
33	DMJL	Përpunimi i procedurave të brendshme mbikëqyrëse për vlerësimin e: 1. Procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm të bankave 2. Modelin e biznesit të bankave
34	DMJL	Përmirësimi i kornizës mbikëqyrës për menaxhimin e rrezikut të PPFT
35	DMJL	Pjesëmarrja në grupet e punës për përcaktimin e rrezikut të PPFT në nivel kombëtar (NRA)
36	GP për sektorin e fintekut	Përpunimi i hulumtimit të anketave mbi sfidat dhe mundësitë e post-pandemisë për zhvillimin e sektorit fintech në vend
37	GP për sektorin e fintekut	Përpunimi i analizës së rreziqeve të reja që lidhen me zhvillimin e sektorit të fintekut
38	GP për sektorin e fintekut	Përpunimi i analizës për vendosjen dhe zbatimin e rregullores në mjedisin e testimit (Regulatory sandbox)
QS3 Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve pagesore të sigurta, inovative dhe efikase		
39	DSP	Përgatitja e informacioneve në fushën e sistemeve pagesore dhe shërbimeve pagesore
40	DSP	Mbikëqyrja e sistemeve pagesore

AKTIVITETET E RREGULLTA PROGRAMORE		
Nr. rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
41	DSP	Kryerja e qarkullimit pagesor me shtetet e huaja në llogari të shtetit dhe autoriteteve shtetërore
42	DSP	Përpunimi dhe shlyerja e transaksioneve që lidhen me administrimin e rezervave valutore dhe zbatimin e politikës monetare, mbikëqyrjen dhe mbështetjen për shlyerjen e transaksioneve në tregje nëpërmjet sporteve
43	DSP	Mbështetja e pjesëmarrësve në MIPS dhe procesimi i urdhërave të përbarimit
QS4 Përmirësimi i politikës investuese dhe siguri i kthimit optimal të rezervave devizore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit		
44	DTF	Menaxhim me rezervat valutore
45	DTF	Zbatimi i kornizës së vendosur me parashikime afatshkurta për lëvizjet e tregjeve financiare në bazë të treguesëve të përzgjedhur tregu/makroekonomi (shkallë pikësh)
QS5 Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit Europian të bankave qendrore		
46	DS	Përgatitja e statistikave të llogarive financiare
47	KG	Aktivitetet lidhur me procesin e anëtarësimit të BPRMV-së në Sistemin Europian të Bankave Qendrore
48	KG	Forcimi i kapaciteteve përmes shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunimit me bankat e tjera qendrore
49	KG	Marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtar
QS6 Rritja e transparencës dhe llogaridhënies		
50	KG	Marrëdhënie me publikun
51	KG	Përkthimi dhe lekturimi i materialeve
52	KG	Punë protokollare
53	DPP	Planifikimi i nevojave për prokurim publik, analiza dhe mbikëqyrja e zbatimit, modifikimi dhe plotësimi i planit vjetor për prokurimin publik
54	DPP	Përgatitja dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik
55	DPP	Mbikëqyrja e kontratave të prokurimit publik dhe pranimi, regjistrimi dhe kontrolli i faturave dhe dokumenteve të tjera kontabël
56	ZPP	Planifikim strategjik
57	DFKK	Publikimi i Raporteve financiare të BPRMV-së dhe mendimi nga revizori i jashtëm
58	Biblioteka	Operim me fondin e bibliotekës dhe realizimi i parapagesave në gazeta dhe baza të të dhënave
59	Biblioteka	Digjitalizimi i materialit arkivor me rëndësi historike
60	Muzeu	Operimi i muzeut me koleksionin
61	Muzeu	Edukim muzeor
62	Muzeu	Punë hulumtuese
QS7 Edukim financiar dhe përfshirje		

AKTIVITETET E RREGULLTA PROGRAMORE		
Nr. rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
63	DMKEF	Edukimi financiar
64	DMKEF	Kontrollet në terren dhe jashtë fushës
65	DMKEF	Përpunimi i raporteve të ankesave
66	DMKEF	Trajtimi i ankesave
67	DMKEF	Hartimi i Ligjit për Avokatin Financiar të Popullit
68	DMKEF	Rishikimi dhe përmirësimi i akteve ligjore dhe nënligjore ekzistuese
QS8 Rritja e vetëdijes për ndryshimet klimatike dhe kontributi në një ekonomi të gjelbër të qëndrueshme		
69	DRrZB	Mbikëqyrja e standardeve ndërkombëtare në fushën e rreziqeve nga ndryshimet klimatike dhe kuptimi i mundësisë së zbatimit të tyre në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut
70	DFM	Mbikëqyrja e rreziqeve nga ndryshimet klimatike
71	DTM	Përpunimi i një metodologjie të brendshme, gjegjësisht procedurë për vlerësimin e rreziqeve në banka që lidhen me ndryshimet klimatike
72	DTF	Kontribut në punën e rrjetit të sistemit financiar të gjelbër
QS 9 - Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore		
73	DAB	Planifikimi dhe përgatitja e programit të punës së auditimit vjetor dhe afatmesëm
74	DAB	Kryerja e auditimit
75	ZPP	Menaxhimi i rreziqeve operationale në nivel të Bankës Popullore
76	ZPP	Përmirësimi i harmonizimit në nivel të Bankës Popullore
77	ZPP	Sigurimi i rrjedhës së punës
78	ZPP	Sigurimi i sigurisë së sistemit të informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale
79	DMTS	Mirëmbajtja e objekteve
80	DMTS	Ofrimi i shërbimeve të transportit
81	DMTS	Siguri fizike, teknike dhe mbrojtje nga zjarri
82	DPJ	Hartimi dhe kontrollimi i akteve juridike të përgjithshme dhe individuale
83	DPJ	Hartimi i dokumenteve ligjore, padive, përgjigje të padive dhe mjeteve emergjente juridike
84	DPJ	Rregullimi i çështjeve pronësore-juridike të Bankës Popullore dhe evidentimi i pasurisë të patundshme
85	DPJ	Përgatitja e mbledhjeve të Këshillit të Bankës Popullore
86	DPJ	Ofrimi i opinioneve ligjore, këshillave dhe kryerja e trajnimeve
87	DPJ	Punë zyre
88	DPJ	Punë arkivore

AKTIVITETET E RREGULLTA PROGRAMORE		
Nr. rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
89	DFKK	Regjistrimi kontabël i transaksioneve që lidhen me kryerjen e funksioneve dhe detyrave të Bankës Popullore, si dhe me punën operative
90	DFKK	Politikat e kontabilitetit dhe raportimi financiar
91	DFKK	Planifikimi dhe kontrolli
92	DFKK	Përgatitja e ndryshimeve në politikat e kontabilitetit të Bankës Popullore dhe rregullat e kontabilitetit për regjistrim, të cilat kanë të bëjnë me ndryshimet e propozuara në Ligjin për Bankën Popullore, në pjesën e kapitalit, rezervave, shpërndarjes së fitimit dhe mbulimit të humbjeve
93	DFKK	Miratimi i një akti të brendshëm në nivel të Bankës Popullore, i cili do të rregullojë në mënyrë gjithëpërfshirëse nënshkrimin elektronik, konfirmimin, inicializimin e dokumenteve për nevoja të brendshme, shpërndarjen e tyre në Bankën Popullore, si dhe ruajtjen dhe arkivimin
KI 1 - Integritet dhe besim në njësinë monetare kombëtare		
94	DOTh	Prodhimi/furnizimi i monedhave dhe kartëmonedhave, kambialet, monedha përkujtimore dhe monedha për koleksionim
95	DOTh	Furnizimi i bankave dhe qendrave të parave të gatshme me para të letrës dhe monedha
96	DOTh	Mbikëqyrja e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha te bankat dhe qendrat për para të gatshme
97	DOTh	Shitja e monedhave jubilarë, monedhave për koleksionim, parave në letra dhe monedhave për qëllime numizmatike dhe të këmbyeshme
98	DOTh	Aktivitetet për nevojat e BPRMV-së, institucioneve shtetërore dhe organeve administrative
KI2 Burimet Njerëzore		
99	DBNj	Sigurimi dhe punësim i punëtorëve
100	DBNj	Krijimi i vendosjes së përshtatshme organizative dhe sistematike
101	DBNj	Rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve të marrëdhënies së punës
102	DBNj	Sigurimi i angazhimit të punonjësve
103	DBNj	Formimi dhe zhvillimi profesional i punonjësve
KI 3 Sistemi informatik		
104	DAP	Përmirësimi dhe mirëmbajtja e aplikacioneve
105	DTI	Mirëmbajtja e infrastrukturës të TI-së
106	DTI	Menaxhimi me mjetet
107	DTI	Ofrimi i shërbimeve të TI-së
108	DTI	Mbrojtja dhe arkivimi
109	DTI	Realizimi i ndryshimeve në sistem
110	DTI	Përmirësimi i serverëve dhe stacioneve të punës
111	DTI	Menaxhimi me incidentet e TI-së

AKTIVITETET E RREGULLTA PROGRAMORE		
Nr. rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
112	DTI	Menaxhimi i llogarive të përdoruesve dhe kontrolli i qasjes në sistem
113	NjMS	Aktivitetet në lidhje me testimin e vazhdimësisë në funksionimin e OE në BPRMV
114	NjMS	Vendosja e shërbimeve të IT-së, mbikëqyrja e përmbushjes së niveleve të caktuara të shërbimit dhe përmirësimi i vazhdueshëm
KI4 Të dhëna statistikore		
115	DS	Përgatitja e statistikave monetare
116	DS	Përgatitja e statistikave të jashtme
117	DS	Raportimi i detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare
118	DS	Sektorizimi i unifikuar i njësive institucionale në kuadër të DS
119	DS	Përgatitja e statistikave të letrave me vlerë
KI 5 Veprimtaria hulumtuese		
120	DPMH	Përpunimi i materialeve të punës: 1. Përmirësimi i modelit të analizës së politikave në ekonominë e brendshme (MAKPAM) 2. Çmimet e naftës dhe ushqimeve në Maqedoninë e Veriut: qasja jolineare ARDL

Shtojca 2

PROJEKTE NGA FUSHA TË ÇAKTUARA NË FUNKSIONIMIN E BANKËS POPULLORE		
Nr.rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
QS3 Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemeve pagesore të sigurt, inovative dhe efikase		
1	DSP	Mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit të ri ligjor në sferën e pagesave
2	DSP	Strategjia për zhvillimin e sistemit pagesor të Republikës së Maqedonisë së Veriut
3	DSP	Pjesëmarrja në aktivitetet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal
4	DSP	Aktivitetet e punës në kuadër të grupeve punuese të themeluara me vendime të Qeverisë së RMV
5	GP për denarin digjital	Denar digjital
QS4 Përmirësimi i politikës së investimeve dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave valutore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit		
6	DTF	Rishikimi i kuadrit për përcaktimin e kufijve të ekspozimit të rezervave valutore
QS5 Përshtatje ndaj standardeve të Sistemit European të bankave qendrore		
7	DS	Dorëzimi i të dhënave për normat e ponderuara të interesit në BQE, në pajtim me kërkesat e transmetimit të të dhënave
8	DS	Pjesëmarrja në projektin IPA-së të EShS-së të tregtisë ndërkombëtare me shërbime
9	DS	Përshtatja e burimeve të të dhënave për statistikën e jashtme në kushtet e liberalizimit të mëtejshëm të transaksioneve kapitale me jorezidentët dhe zbatimin e rregulloreve të BE-së për shërbimet pagesore dhe sistemet pagesore
QS6 Rritja e transparencës dhe llogaridhënies		
10	KG	Thellimi i bashkëpunimit me subjektet kryesore në komunikim me publikun
11	KG	Ruajtja e transparencës në komunikimin korporativ
QS7 Edukimi financiar dhe gjithëpërfshirja		
12	MKEF	Strategjia e edukimit financiar dhe përfshirjes financiare të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021 - 2025
QS8 Rritja e vetëdijes për ndryshimet klimatike dhe kontributi në një ekonomi të gjelbër të qëndrueshme		
13	DTF	Shqyrtimi i mundësisë për të ndarë një portofol të veçantë të bonove të gjelbra
14	DTF	Rishikimi i parametrave për matjen e rrezikut nga ndryshimet klimatike në menaxhimin e rezervave valutore dhe efektin e investimeve në bonot e gjelbra në përmirësimin e mjedisit

PROJEKTE NGA FUSHA TË CAKTUARA NË FUNKSIONIMIN E BANKËS POPULLORE		
Nr.rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
QS9 Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore		
15	DMTS	Ndërtimi i objektit të ri të BPRMV-së
16	DMTS	Pajisjet për furnizim të pandërprerë me energji elektrike
17	DMTS	Rrjeti i energjisë në vendndodhjen rezervë
18	DFKK	Aktivitete për përcaktimin e kërkesave për përgatitjen e sistemit të kontabilitetit të BPRMV-së për qëllime të raportimit statistikor lidhur me projektin ISIDORA të BPRMV-së
KI1 Integriteti dhe besimi në njësinë monetare kombëtare		
19	DOTh	Sigurimi i funksionalitetit të modulit për shkëmbim elektronik të të dhënave me Drejtorinë e Doganave
KI3 Sistemi Informacionit		
20	DAP	Vendosja e një mjeti për të ruajtur kodin burimor për bazat e të dhënave
21	DAP	Vendosja e një mjeti për testimin statik të aplikacioneve
22	NjMS	Përmirësimi i mbikëqyrjes së ngjarjeve dhe incidenteve të sigurisë
23	DIT	Projekt për forcimin e kapaciteteve të Bankës Popullore për statistika dhe sistemet pagesore
24	NjMS	Projekt për të vendosur shërbimet e IT në "cloud"
KI4 Të dhënat statistikore		
25	DS	Analiza dhe përgatitja e të dhënave për investimet direkte me shfaqje të kryqësuar vend- aktivitet
26	DS	Pasurimi i grupit të të dhënave të disponueshme në NBStat

Shtojca 3

PROJEKTE PËR ORGANIZIM TË NGJARJEVE		
Nr. rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
QS6 Rritja e transparencës dhe llogaridhënies		
1	KG	Organizimi i ngjarjeve si platformë për diskutim mbi temat përkatëse
QS7 Edukimi financiar dhe gjithëpërfshirja		
2	DMKEF	Java Globale e Parasë
3	DMKEF	Kuizi European i Parasë
4	DMKEF	Ditët e Edukimit Financiar
5	DMKEF	Dita Botërore e Kursimit
6	DMKEF	Edukimi financiar i personave me aftësi të veçanta
7	DMKEF	Edukimi financiar dhe përfshirja financiare për gratë sipërmarrëse
QS8 Rritja e vetëdijes për ndryshimet klimatike dhe kontributi për një ekonomi të gjelbër të qëndrueshme		
8	ZKM	Konferencë për financat e gjelbra

Shtojca 4

PROJEKTET E ZHVILLIMIT TË SOFTUERËVE		
Nr.rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
QS1 Përmirësimi i infrastrukturës për udhëheqje të politikës monetare		
1	DTF	Përmirësimi i bazës analitike për mbikëqyrjen e efikasitetit të masave në rezervën e detyrueshme
2	DTF	Përmirësimi i funksionalitetit të sistemit elektronik për bonot e thesarit
3	DTF	Pasurimi i bazës analitike për mbikëqyrjen e tregut valuto
QS2 Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar		
4	DMJL	Përmirësimi i aplikacionit ekzistues (angl. CRIS)
QS3 Mbështetja e popullsisë dhe sektorit korporativ nëpërmjet zhvillimit të sistemve pagesore të sigurta, innovative dhe efikase		
5	DSP	Avancim i zgjidhjes aplikative për statistikën pagesore
6	DSP	Përmirësimi i aplikacionit për kryqëzimin e letrave me vlerë të cilat tregtohen në tregun sekondar (SISX)
7	DSP	Përmirësimi i RegNBRM, StatistikaPS, KIBS, analizat KIBS dhe kërkimet KIBS
8	DSP	Përmirësimi i aplikacionit kundër larjes së parave (AML)
QS4 Përmirësimi i politikës së investimeve dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave valutore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit		
9	DTF	Vendosja e portofoleve të reja në kuadrin e rezervave valutore
QS5 Përshtatja ndaj standardave të Sistemit European të bankave qendrore		
10, 11	DS	Vendosja e sistemit të raportimit nga Banka Popullore, bankat, kursimoret për qëllime statistikore dhe mbikëqyrëse – dy projekte për zhvillimin e softuerit (ISIDORA)
12	DS	Aktivitetet për krijimin e sistemit për udhëheqjen, ruajtjen, përpunimin dhe trajtimin e të dhënave statistikore, krijimin e depos së të dhënave
QS7 Edukimi financiar dhe përfshirja		
13	MKEF	Krijimi i një aplikacioni për krahasimin e të dhënave për kreditë dhe depozitat bankare (me një furnizues të jashtëm)
QS9 Forcimi i udhëheqjes me rreziqet në nivel të Bankës Popullore		
14	ZPP	Përmirësimi i Qendrës së Shërbimit KSP- incidente, në pjesën për rreziqet operative
15	DFKK	Sistem i integruar i kontabilitetit

PROJEKTET E ZHVILLIMIT TË SOFTUERËVE		
Nr.rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
16	DFKK	Përmirësimi i aplikacionit për konfirmim elektronik të faturave dhe dokumenteve të tjera të pagesave (eFaturat)
17	DFKK	Përmirësimi i aplikacionit Operacionet e Integruara të Materialeve (OIM)
18	DFKK	Zgjidhje e re aplikative e faturave dalëse
19	DFKK	Përmirësim i aplikacionit për planifikim- 278
KI1 Integriteti dhe besimi në njësinë monetare kombëtare		
20	DOTh	Përmirësim i aplikacionit 249- ekspertizën e falsifikimit
PROJEKTET E ZHVILLIMIT TË SOFTUERËVE		
Nr. rendor	Njësia organizative	Emri i aktivitetit të programit
KI3 Sistemi i infomacionit		
21	DAP	Përkthimi i aplikacioneve në ueb-faqen e BPRMV-së në gjuhën shqipe
KI4 Të dhëna statistikore		
22	DS	Hartim të sistemit për pranim të të dhënave të shkëmbimit të jashtëm tregtar nga sistemi i ri i Drejtorisë së Doganave të Republikës së Maqedonisë së Veriut
23	DS	Racionalizimi i procesit të mbledhjes së të dhënave për investimet me vendet e jashtme përmes implementimit të njoftimit elektronik
24	DS	Racionalizimi i procesit të mbledhjes së të dhënave për aktivitetet kreditore me vendet e jashtme përmes implementimit të njoftimit elektronik



BANKA POPULLORE E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
